



QENDRA E SHËRBIMEVE ARSIMORE

PROVIMET KOMBËTARE TË ARSIMIT BAZË 2022 (KLASA 9-të)

RAPORT PUBLIK

MBI

ARRITJET E NXËNËSVE

Përmbledhja

<u>Hyrje</u>	3
<u>Tabela e shkurtimeve</u>	3
<u>1. Metodologjia</u>	4
<u>2. Statistika përmbledhëse për PKAB 2022</u>	5
<u>3. Statistika Krahasuese PKAB 2019-2021</u>	6
<u>I. Lënda: Gjuhë Shqipe</u>	7
<u>1.1 Arritjet e Nxënësve</u>	7
<u>1.2 Arritjet në nivel kombëtar</u>	10
<u>1.3 Arritjet sipas gjinisë</u>	11
<u>1.4 Arritjet sipas urbanizimit qytet/fshat</u>	12
<u>1.5 Arritjet sipas sistemit publik/jopublik të edukimit</u>	12
<u>1.6 Qëndrueshmëria e arritjeve</u>	13
<u>1.7 Qëndrueshmëria e arritjeve sipas urbanizimit qytet/fshat</u>	15
<u>1.8 Arritjet sipas gjinisë femra/meshkuj</u>	17
<u>1.9 Të dhëna të tjera për rezultatet e provimit të Gjuhës shqipe</u>	20
<u>II. Lënda: Matematikë</u>	23
<u>2.1 Arritjet e Nxënësve</u>	23
<u>2.2 Arritjet në nivel kombëtar</u>	24
<u>2.3 Arritjet sipas urbanizimit qytet/fshat</u>	26
<u>2.4 Arritjet sipas gjinisë</u>	26
<u>2.5 Arritjet sipas sistemit publik/jopublik të edukimit</u>	27
<u>2.6 Qëndrueshmëria e arritjeve</u>	27
<u>2.7 Arritjet sipas urbanizimit qytet/fshat</u>	30
<u>2.8 Arritjet sipas gjinisë femra/meshkuj</u>	31
<u>2.9 Të dhëna të tjera për rezultatet e provimit të Matematikës</u>	33
<u>III. Lënda: Gjuhë e Huaj</u>	35
<u>3.1 Arritjet e Nxënësve</u>	36
<u>3.2 Në nivel kombëtar</u>	40
<u>3.3 Arritjet sipas urbanizimit qytet/fshat</u>	40
<u>3.4 Arritjet sipas gjinisë</u>	40
<u>3.5 Arritjet sipas sistemit publik/jopublik të edukimit</u>	40
<u>3.6 Të dhëna të tjera për rezultatet e provimit të Gjuhës së huaj</u>	41
<u>IV. Renditja e shkollave në bazë të mesatares së arritjeve në Provimet Kombëtare të Arsimit Bazë</u>	48

Hyrje

Matja e arritjeve të nxënësve në përfundim të një niveli arsimor shërben jo vetëm për të pasqyruar funksionimin e sistemit arsimor dhe kontekstin e politikave arsimore aktuale, por edhe për të ndërtuar politika të reja arsimore. Rezultatet e nxënësve përfaqësojnë treguesin kryesor të cilësisë dhe të performancës së sistemit arsimor, sidomos kur kjo lidhet me synimin për pajisjen e nxënësve me njohuri dhe me kompetenca për përballimin e kërkesave të kohës.

Raporti publik i Provimeve Kombëtare të Arsimit Bazë 2022 shërben për t'u siguruar politikëbërësve, përdoruesve dhe publikut informacion për rezultatet e nxënësve dhe për faktorët që ndikojnë në to. Ai synon të kontribuojë në zhvillimin dhe analizën e treguesve sasiorë krahasimorë të vlerësimit të jashtëm të arritjeve të nxënësve të klasës së nëntë.

Informacioni është i organizuar në mënyrë të tillë që mundëson jo vetëm njohjen e arritjeve të nxënësve në nivel ZVA-je, por njëkohësisht edhe krahasimin mes ZVA-ve, duke iu referuar edhe arritjeve në nivel kombëtar.

Tabela e shkurtimeve

MAS – Ministria e Arsimit dhe Sportit

QSHA – Qendra e Shërbimeve Arsimore

ZVA – Zyra Vendore Arsimore

PKAB – Provimi Kombëtar i Arsimit Bazë

NV – Nota Mesatare Vjetore

NP – Nota Mesatare e Provimit

NV_k – Nota Mesatare në nivel Kombëtar

NP_k – Nota Mesatare e Provimit në nivel Kombëtar

1. Metodologjia

Informacioni statistikor i këtij raporti është bazuar në databazën e krijuar nga QSHA gjatë procesit të organizimit dhe realizimit të Provimeve Kombëtare të Arsimit Bazë 2022 (këtu e në vijim PKAB). Baza e të dhënave përmban informacion statistikor në nivel nxënësi mbi arritjet në lëndët: Gjuhë shqipe, Matematikë dhe Gjuhë e huaj.

Fushat kryesore të bazës së të dhënave janë:

- ZVA (së cilës i përket shkolla që ka ndjekur nxënësi);
- shkolla e ndjekur;
- gjinia e nxënësit;
- lloji i shkollës (publike/jopublike);
- vendndodhja e shkollës (fshat/qytet);
- kalueshmëria gjatë vitit shkollor 2021-2022;
- pikët e fituara në provime nga çdo nxënës;
- notat në provimet e arsimit bazë;
- notat vjetore të fituara nga nxënësit gjatë vitit shkollor (për lëndët e provimeve të arsimit bazë).

Të dhënat mbi arritjet mesatare të nxënësve në PKAB 2022 janë paraqitur:

- në nivel kombëtar;
- në nivel ZVA-je;
- sipas urbanizimit (fshat/qytet);
- sipas gjinisë (femra/meshkuj);
- sipas llojit të shkollës (publike/jopublike).

Në përpunimin statistikor të të dhënave, janë përfshirë të dhënat e arritjeve të nxënësve të vitit shkollor 2021-2022, të cilët morën pjesë në PKAB 2022, në sesionin e parë. Informacioni statistikor i përfutur nga përpunimi është paraqitur në formë tabelare dhe/ose grafike.

Raporti përmban treguesit e mëposhtëm statistikorë:

- mesatarja e pikëve të fituara në testim;
- nota mesatare vjetore (NV);
- nota mesatare e provimit (NP);
- shmangia standarde - (*shmangia mesatare e të dhënave nga mesatarja e tyre*);
- nota mesatare vjetore në nivel kombëtar (NVk);
- nota mesatare e provimit në nivel kombëtar (NPk);
- kalueshmëria në provimin kombëtar të Arsimit Bazë;
- diferenca e Notës Vjetore me Notën Vjetore në nivel kombëtar ($NV - NVk$);
- diferenca e Notës së provimit me Notën e provimit në nivel kombëtar ($NP - NPk$).

2. Statistika përmbledhëse për PKAB 2022

Tabela 1.1, paraqet të dhëna statistikore përmbledhëse për PKAB 2022, për sesionin e parë. Në tabelën 1.1 është paraqitur numri i nxënësve sipas lëndëve/provimeve të Arsimit Bazë 2022, të klasifikuar sipas kategorive: publik/jopublik, fshat/qytet, femra/meshkuj, arritjet e të cilëve janë përdorur për përgatitjen e këtij raporti.

Tabela 1.1: Të dhëna statistikore përmbledhëse për provimet e PKAB 2022.

Nr.	Lënda	Numri i nxënësve që morën pjesë në PKAB		
		Total	Publik	Jopublik
1	Gjuhë shqipe (Total)	28957	26601	2356
	Qytet	16876	14555	2321
	Fshat	12081	12046	35
	Femra	13987	12820	1167
	Meshkuj	14970	13781	1189
2	Matematikë (Total)	28986	26626	2360
	Qytet	16887	14563	2324
	Fshat	12099	12063	36
	Femra	14000	12832	1168
	Meshkuj	14986	13794	1192
3	Gjuhë e Huaj (Total)	28859	26506	2353
	Qytet	16838	14520	2318
	Fshat	12021	11986	35
	Femra	13948	12781	1167
	Meshkuj	14911	13725	1186

3. Statistika Krahasuese PKAB 2019-2022

Tabela 1.2, paraqet të dhëna statistikore përmblledhëse për **PKAB 2019 - 2022**.

Tabela 1.2: Të dhëna statistikore përmblledhëse për dy vitet e fundit.

Nr.	Lënda	Numri i nxënësve që morën pjesë në provim			Kalueshmëria në provim	Nota mesatare në PKAB
		Total	Publik	Jopublik	(në %)	
2022						
1	Gjuhë shqipe	28957	26601	2356	99.84 %	8.19
2	Matematikë	28986	26626	2360	99.9 %	7.45
3	Gjuhë e Huaj	28859	26506	2353	99.92 %	8.47
Të gjitha lëndët		86802	79733	7069	99.88 %	8.03
2021						
1	Gjuhë shqipe	30391	28090	2301	99.49 %	7.73
2	Matematikë	30369	28065	2304	99.3 %	7.00
3	Gjuhë e Huaj	30211	27912	2299	99.89 %	8.62
Të gjitha lëndët		90971	84067	6904	99.56 %	7.78
2019						
1	Gjuhë shqipe	34429	31954	2475	99.61%	7.76
2	Matematikë	34438	31968	2470	99.39%	7.06
3	Gjuhë e Huaj	34300	31826	2474	99.84%	8.47
Të gjitha lëndët		103167	95748	7419	99.61%	7.76

Nga krahasimi i të dhënave të PKAB të dy viteve të fundit, për të gjitha lëndët rezultojnë se:

- kalueshmëria e nxënësve në PKAB 2022, është **0.32%** më e lartë në krahasim me vitin 2021.
- nota mesatare, krahasuar me vitin 2021 është **0.25** njësi note më e lartë.

I. Lënda: Gjuhë Shqipe

1.1 Arritjet e Nxënësve

Në provimin e lëndës së Gjuhës shqipe morën pjesë **28957** nxënës. **Tabela 1.3** paraqet pikët mesatare të fituara nga nxënësit e çdo ZVA-je në PKAB, të lëndës Gjuhë Shqipe.


Tabela 1.3: Arritjet mesatare për çdo ZVA.

Nr.	ZVA	Pikë mesatare	Shmangia mesatare	Nota mesatare e provimit	Shmangia mesatare	Nota mesatare vjetore	Shmangia mesatare
	Në nivel kombëtar	34.84	9.53	8.19	1.33	7.48	1.72
1	Belsh	32.92	8.88	7.93	1.25	7.11	1.65
2	Berat	35.88	9.03	8.34	1.26	7.63	1.69
3	Bulqizë	26.74	11.28	7.14	1.58	7.03	1.73
4	Cërrik	31.32	10.25	7.68	1.48	7.19	1.69
5	Devoll	38.77	8.18	8.72	1.17	7.71	1.68
6	Dibër	30.35	8.61	7.59	1.20	7.05	1.78
7	Divjakë	34.89	8.56	8.23	1.18	7.12	1.74
8	Durrës	36.60	9.57	8.43	1.32	7.45	1.71
9	Elbasan	33.57	10.52	7.92	1.52	7.35	1.74
10	Fier	37.55	8.71	8.56	1.21	7.58	1.82
11	Finiq-Dropull	39.02	8.17	8.81	1.17	7.96	1.64
12	Gjirokastrë-Libohovë	37.66	8.32	8.59	1.17	7.57	1.72
13	Gramsh	36.65	8.63	8.47	1.23	8.30	1.38
14	Has	37.48	9.28	8.60	1.29	8.06	1.89
15	Kamzë	31.07	8.90	7.68	1.22	7.04	1.61
16	Kavajë	35.85	9.87	8.34	1.39	7.52	1.79
17	Klos	29.29	9.47	7.46	1.33	7.16	1.59
18	Kolonje	34.94	8.86	8.21	1.24	7.60	1.75
19	Korçë-Pustec	34.97	9.45	8.17	1.33	7.70	1.77
20	Krujë	29.61	9.62	7.46	1.30	7.47	1.75
21	Kuçovë	31.42	10.07	7.60	1.42	7.16	1.55
22	Kukës	33.48	8.84	8.00	1.21	7.44	1.67
23	Kurbin	36.09	8.86	8.35	1.24	7.68	1.67
24	Lezhë	34.29	9.31	8.14	1.27	7.37	1.70
25	Librazhd	34.41	8.63	8.10	1.21	7.68	1.65
26	Lushnje	35.44	9.00	8.28	1.25	7.72	1.82
27	Malësi e Madhe	32.50	9.89	7.87	1.38	7.19	1.66
28	Maliq	33.88	9.62	8.05	1.36	7.26	1.76
29	Mallakastër	36.19	9.06	8.36	1.30	7.69	1.58

30	Mat	31.28	9.41	7.74	1.31	7.45	1.55
31	Mirditë	33.86	9.47	8.06	1.32	7.53	1.71
32	Patos	32.28	9.31	7.89	1.29	7.28	1.66
33	Peqin	34.78	10.77	8.15	1.51	7.66	1.68
34	Përmet-Këlcyrë	34.58	9.15	8.17	1.32	7.31	1.59
35	Përrenjas	35.23	8.37	8.25	1.17	7.17	1.61
36	Pogradec	37.85	9.18	8.61	1.29	7.97	1.61
37	Polican	31.24	9.55	7.70	1.34	7.06	1.68
38	Pukë	33.52	9.20	8.03	1.43	7.65	1.51
39	Roskovec	30.27	9.36	7.57	1.29	7.19	1.60
40	Rrogozhinë	34.45	9.60	8.13	1.32	6.98	1.67
41	Sarandë-Konispol - Delvinë	33.93	8.98	8.08	1.20	7.23	1.63
42	Selenicë	34.34	8.72	8.19	1.11	7.39	1.54
43	Shijak	33.40	9.65	7.99	1.33	7.18	1.62
44	Shkodër	34.52	9.32	8.15	1.30	7.30	1.75
45	Skrapar	28.31	10.45	7.32	1.43	7.35	1.65
46	Tepelenë-Memaliaj	35.66	9.90	8.30	1.38	7.75	1.64
47	Tiranë	36.99	8.67	8.51	1.22	7.72	1.69
48	Tropojë	35.78	9.42	8.34	1.30	7.53	1.74
49	Ura vajguore	31.22	10.05	7.73	1.40	7.00	1.68
50	Vau Dejës	31.01	10.59	7.66	1.46	7.04	1.72
51	Vlorë-Himarë	35.72	9.75	8.32	1.36	7.64	1.71
52	Vorë	32.64	9.43	7.90	1.34	7.10	1.79

Të dhënat e kësaj tablele janë paraqitur në **grafikun 1.1**. Grafiku tregon mesataret e pikëve të secilës ZVA, duke i krahasuar ato me mesataren e pikëve në nivel kombëtar.

Arritjet mesatare në Gjuhën Shqipe



Grafiku 1.1: Arritjet mesatare për çdo ZVA.

1.2 Arritjet në nivel kombëtar

- **Mesatarja e pikëve** të fituara në provimin e Gjuhës shqipe është **34.84 pikë**, me shmangie mesatare **9.53**.
- **Nota mesatare e provimit** është **8.19**, me shmangie mesatare **1.33**.
- **Nota mesatare vjetore** është **7.48**, me shmangie mesatare **1.72**.

Nga krahasimi i vlerave të notës mesatare vjetore me notën mesatare të provimit të arsimit bazë, referuar po nivelit kombëtar, rezulton se nota mesatare e provimit kombëtar është **0.71** njësi notë më e lartë se nota mesatare vjetore.

Gjithashtu, vëmë re se pothuajse në të gjitha ZVA-të, arritjet mesatare të nxënësve në provim janë më të larta, sesa arritjet mesatare të tyre gjatë vitit. ZVA Rrogozhinë, dallohet për diferencë më të lartë midis notës vjetore dhe asaj së provimit (nota mesatare vjetore **6.98**, nota mesatare e provimit **8.13**).

Arritjet mesatare të nxënësve në provim janë më të ulta krahasuar me arritjet mesatare vjetore, në:

- në ZVA Krujë, ku rezulton se nota mesatare vjetore është **0.01** njësi notë më e lartë se nota mesatare e provimit kombëtar;
- në ZVA Skrapar, nota mesatare vjetore është **0.03** njësi notë më e lartë se nota mesatare e provimit kombëtar;

Tabela 1.4 paraqet arritjet mesatare të nxënësve në lëndën e Gjuhës shqipe. Arritjet e nxënësve janë dhënë **në nivel kombëtar**, sipas **urbanizimit fshat/qytet**, sipas **gjinisë femra/meshkuj**, si edhe sipas **sistemit publik/jopublik të edukimit**.

Tabela 1.4: Arritjet mesatare të nxënësve sipas kategorive.

Urbanizimi	Gjinia	Pikët e fituara në test		Nota e PKAB		Nota Vjetore	
		Mesatarja e pikëve	Shmangia mesatare	Nota mesatare	Shmangia mesatare	Nota mesatare	Shmangia mesatare
Në nivel kombëtar	F	38.13	8.30	8.64	1.17	8.13	1.54
	M	31.76	9.58	7.78	1.34	6.87	1.65
	Grand Total	34.84	9.53	8.19	1.33	7.48	1.72
Qytet	Femra	39.96	7.58	8.89	1.09	8.33	1.52
	Meshkuj	34.10	9.28	8.09	1.30	7.15	1.71
	Total	36.90	9.00	8.48	1.27	7.71	1.73
Fshat	Femra	35.62	8.58	8.29	8.29	7.86	1.53
	Meshkuj	28.44	9.01	7.33	7.33	6.49	1.48
	Total	28.87	9.34	7.38	1.31	7.16	1.65
Publik	Femra	37.68	8.38	8.57	1.18	8.06	1.55

(në nivel kombëtar)	Meshkuj	31.08	9.46	7.69	1.32	6.76	1.62
	Total	30.90	9.55	7.67	1.34	7.39	1.71
Qytet	Femra	39.43	7.78	8.81	1.11	8.23	1.55
	Meshkuj	33.24	9.28	7.98	1.30	6.98	1.69
	Total	36.19	9.14	8.38	1.29	7.58	1.74
Fshat	Femra	35.62	8.58	8.29	1.20	7.86	1.53
	Meshkuj	28.41	9.00	7.32	1.25	6.48	1.48
	Total	31.93	9.51	7.80	1.32	7.16	1.66
Jopublik (në nivel kombëtar)	Femra	43.06	5.32	9.35	0.79	8.95	1.19
	Meshkuj	39.65	7.10	8.85	1.02	8.19	1.50
	Total	41.34	6.51	9.10	0.95	8.57	1.41
Qytet	Femra	43.11	43.11	9.36	0.78	8.96	1.19
	Meshkuj	39.69	39.69	8.86	1.02	8.20	1.50
	Total	41.39	41.39	9.11	0.94	8.58	1.41
Fshat	Femra	38.36	9.49	8.73	1.42	8.64	1.36
	Meshkuj	37.58	7.93	8.50	1.06	7.67	1.52
	Total	37.83	8.32	8.57	1.17	7.97	1.52

1.3 Arritjet sipas gjinisë

Krahasueshmëria mes arritjeve mesatare të vajzave dhe djemve, për nivelin kombëtar, tregon se:

- arritjet mesatare për vajzat janë më të larta, krahasuar me arritjet mesatare të djemve.
- mesatarja e pikëve të fituara nga vajzat është rreth **6.37 pikë** më e lartë, krahasuar me mesataren e pikëve të fituara nga djemtë.

Nëse krahasojmë diferencat që ekzistojnë mes arritjeve të nxënësve-vajza, në provimet kombëtare, me arritjet vjetore të tyre, rezulton se vajzat kanë një qëndrueshmëri më të mirë të rezultateve në provimin e arsimit bazë, kundrejt arritjeve vjetore të tyre (nota mesatare në PKAB është **8.64**, kundrejt **8.13** që është nota mesatare vjetore).

Nëse krahasojmë diferencat që ekzistojnë mes arritjeve të nxënësve-djem, me arritjet vjetore të tyre, rezulton se djemtë kanë marrë një vlerësim më të lartë në rezultate në provimin e arsimit bazë, kundrejt arritjeve vjetore të tyre (nota mesatare në PKAB është **7.78**, kundrejt **6.87** që është nota mesatare vjetore).

1.4 Arritjet sipas urbanizimit qytet/fshat

Nëse do të analizojmë arritjet e nxënësve, në nivel kombëtar, sipas elementëve të urbanizimit qytet/fshat, rezulton se:

- ekzistojnë diferenca mes arritjeve të nxënësve që kanë ndjekur shkollën në qytet, kundrejt atyre që e kanë ndjekur shkollën në fshat.
- mesatarja e pikëve të fituara nga nxënësit e qytetit rezulton të jetë rreth **8.03** pikë më e lartë, ndaj nxënësve të fshatit.

Ekzistenca e diferencës prej **8.03 pikësh** në mesataren e pikëve pasqyrohet edhe në diferencën e notës mesatare të PKAB-së që ekziston mes dy kategorive, vlera e së cilës është me **1.1** njësi notë.

Në nivel kombëtar, diferenat e arritjeve midis kategorive Qytet dhe Fshat janë përkatësisht: për vajzat **4.34** pikë, ndërsa për djemtë **5.66** pikë.

Për të tre treguesit statistikorë të tabelës 1.4, shihet se arritjet e vajzave në qytet janë më të larta kundrejt arritjeve të vajzave të fshatit.

Nëse i referohemi arritjeve mesatare vjetore, vajzat e qytetit kanë një notë mesatare vjetore me një vlerë prej **0.47** më të lartë se vajzat e fshatit. Kjo diferencë arrin deri në **0.47** njësi note, nëse i referohemi arritjeve në provimin kombëtar të arsimit bazë.

Nëse i referohemi arritjeve mesatare vjetore, djemtë e qytetit kanë një notë mesatare vjetore me një vlerë prej **0.66** më të lartë se djemtë e fshatit. Kjo diferencë arrin deri në **0.66** njësi note, nëse i referohemi arritjeve në provimin kombëtar të arsimit bazë.

1.5 Arritjet sipas sistemit publik/jopublik të edukimit

Diferenca të mëdha ekzistojnë edhe mes dy sistemeve arsimore (publik/jopublik). Nga të dhënat e tabelës 1.4, rezulton se arritjet mesatare të nxënësve në sistemin jopublik të edukimit janë më të larta se arritjet mesatare të nxënësve në sistemin publik.

Kjo situatë qëndron si për mesataren e pikëve në provim, po ashtu edhe për notën mesatare të provimit dhe atë vjetore.

Të njëjtat dallime ekzistojnë, edhe nëse krahasojmë arritjet e nxënësve femra/meshkuj në sistemin publik me arritjet e nxënësve femra/meshkuj në sistemin jopublik, si edhe për kategoritë fshat/qytet në sistemin publik, kundrejt kategorive fshat/qytet në sistemin jopublik.

1.6 Qëndrueshmëria e arritjeve


Nëse do të analizojmë qëndrueshmërinë e arritjeve të nxënësve në provimin e arsimit bazë, kundrejt arritjeve vjetore, duke krahasuar notën mesatare vjetore me notën mesatare të provimit, shihet se qëndrueshmëria e arritjeve në sistemin publik është **(0.28)** dhe për atë jopublik **(0.53)**.

Paqëndrueshmëria më e madhe vihet re në kategorinë - meshkuj si në sistemin publik **(0.93)**, ashtu edhe në atë jopublik **(0.66)**. Vajzat kanë arritje më të qëndrueshme krahasuar me djemtë. Për sistemin publik, për kategorinë - vajza, diferenca midis notës mesatare të PKAB me notën mesatare vjetore është vetëm **(0.51)** dhe në atë jopublik vetëm **(0.4)**.

Tabela 1.5 dhe Grafiku 1.2, paraqesin shpërndarjen (në përqindje) të notave të provimit të arsimit bazë për lëndën e Gjuhës shqipe.

Tabela 1.5: Shpërndarja e notave të provimit të arsimit bazë.

Sistemi i edukimit	Nota e PKAB në Gjuhë shqipe						
	Nota 4	Nota 5	Nota 6	Nota 7	Nota 8	Nota 9	Nota 10
Publik	0.14%	3.07%	8.19%	17.36%	24.23%	23.79%	15.08%
Jopublik	0.00%	0.04%	0.09%	0.36%	1.31%	3.10%	3.25%
Në nivel kombëtar	0.14%	3.11%	8.28%	17.72%	25.53%	26.89%	18.33%




Grafiku 1.2: Shpërndarja e notave të provimit të arsimit bazë.

Tabela 1.6 dhe Grafiku 1.3, paraqesin shpërndarjen e notave vjetore për lëndën e Gjuhës shqipe.

Tabela 1.6: Shpërndarja e notave vjetore.

Sistemi i edukimit	Nota vjetore në Gjuhë shqipe					
	Nota 5	Nota 6	Nota 7	Nota 8	Nota 9	Nota 10
Publik	17.01%	16.09%	15.27%	15.41%	13.88%	14.21%
Jopublik	0.21%	0.60%	1.13%	1.53%	1.76%	2.91%
Në nivel kombëtar	17.22%	16.69%	16.40%	16.94%	15.63%	17.12%



Grafiku 1.3: Shpërndarja e notave vjetore.

Në nivel kombëtar, në provimin e arsimit bazë, lënda Gjuhë Shqipe:

- kalueshmëria është 99.84%
- nota me përqindjen më të lartë është **nota 9 me 26.88%**.
- përqindja e nxënësve të vlerësuar me **notën 10** në nivel kombëtar për PKAB 2022 është e lartë (**18.33%**).


1.7 Qëndrueshmëria e arritjeve sipas urbanizimit qytet/fshat

Në **tabelën 1.7**, paraqiten përqindjet për notat e provimit PKAB dhe ato vjetore sipas kategorisë qytet dhe fshat.

- të dhënat tregojnë se përqindja e nxënësve që kanë marrë notën 10 në provimin e Arsimit Bazë, 18.33% e totalit të nxënësve, prej të cilëve 3.88% janë nxënës që i përkasin kategorisë - fshat, dhe 14.45% i përkasin kategorisë – qytet;
- rezultatet e arritura në provimin e arsimit bazë, si dhe ato vjetore të nxënësve të qytetit janë përgjithësisht më të larta, kundrejt nxënësve të fshatit;
- në notat e provimit të arsimit bazë, nxënësit e qytetit dhe të fshatit e kanë përqindjen më të lartë në notën 8, ndërsa për notën 9, përqindja e nxënësve të qytetit është dyfish më e lartë, krahasuar me nxënësit e fshatit;
- nëse shohim arritjet e nxënësve për notat 4-7, përqindja e nxënësve të fshatit është më e lartë, krahasuar me ata të qytetit, ndërsa për notat 8-10 ndodh e kundërta. Në këtë interval note (8-10), përqindja e nxënësve të qytetit është më e lartë;
- në notat vjetore, nxënësit e qytetit e kanë përqindjen më të lartë në notën 10 me **12.62%** ndërsa nxënësit e fshatit në notën 5 me **8.89%**

Tabela 1.7: Arritjet në PKAB sipas urbanizimit.

Urbanizimi	Nota e PKAB në Gjuhë shqipe						
	Nota 4	Nota 5	Nota 6	Nota 7	Nota 8	Nota 9	Nota 10
Qytet	0.03%	1.13%	3.32%	8.26%	13.76%	17.33%	14.45%
Fshat	0.11%	1.99%	4.96%	9.46%	11.77%	9.56%	3.88%
Në nivel kombëtar	0.14%	3.11%	8.28%	17.72%	25.53%	26.89%	18.33%




Grafiku 1.4: Arritjet në PKAB-së sipas urbanizimit.

Në **tabelën 1.8**, paraqiten përqindjet për arritjet vjetore në lëndën e Gjuhës Shqipe kategorisë qytet dhe fshat.

Tabela 1.8: Arritjet vjetore sipas urbanizimit.

Urbanizimi	Nota vjetore në Gjuhë shqipe					
	Nota 5	Nota 6	Nota 7	Nota 8	Nota 9	Nota 10
Qytet	8.32%	8.71%	9.13%	9.93%	9.57%	12.62%
Fshat	8.89%	7.98%	7.26%	7.02%	6.06%	4.50%
Në nivel kombëtar	17.22%	16.69%	16.39%	16.95%	15.63%	17.12%



Grafiku 1.5: Arritjet vjetore sipas urbanizimit.

1.8 Arritjet sipas gjinisë femra/meshkuj

Nga të dhënat e paraqitura më poshtë (në formë tabelare dhe grafike) për arritjet në provimin kombëtar, si dhe ato për arritjet gjatë vitit shkollor, mund të veçojmë:


Për provimin e arsimit bazë:

- vajzat kanë rezultate më të larta se djemtë, si gjatë vitit shkollor, po ashtu edhe në provimin e arsimit bazë;
- vajzat kanë përqindjen më të lartë në notën 9 me **15.99%** për arritjet në provimin e arsimit bazë. Ndërkohë që djemtë kanë notën 8 me **13.98%**
- vajzat kanë përqindjen më të madhe në notat 9 dhe 10, ndërsa djemtë në notat 7 dhe 8.

Tabela 1.9: Arritjet PKAB sipas gjinisë.

Gjinia	Nota e PKAB në Gjuhë shqipe						
	Nota 4	Nota 5	Nota 6	Nota 7	Nota 8	Nota 9	Nota 10
Femra	0.03%	0.64%	1.76%	5.43%	11.55%	15.99%	12.90%
Meshkuj	0.11%	2.47%	6.51%	12.29%	13.98%	10.90%	5.43%

Në nivel kombëtar	0.14%	3.11%	8.28%	17.72%	25.53%	26.89%	18.33%
--------------------------	-------	-------	-------	--------	--------	--------	--------




Grafiku 1.6: Arritjet në PKAB sipas gjinisë.

Për arritjet gjatë vitit shkollor:

- vajzat kanë përqindjen më të lartë në notën 10 me **12.10%**, për notën vjetore, ndërsa djemtë kanë notën 5 me **14.19%**
- vajzat kanë përqindje më të lartë në notat 9 dhe 10, respektivisht me **10.17%** dhe **12.10%**
- djemtë kanë përqindje më të lartë në notat 5 dhe 6, respektivisht me **14.19%** dhe **11.25%**.

Tabela 1.10: Arritjet vjetore sipas gjinisë.

Gjinia	Nota vjetore në Gjuhë shqipe					
	Nota 5	Nota 6	Nota 7	Nota 8	Nota 9	Nota 10
Femra	3.04%	5.44%	7.83%	9.72%	10.17%	12.10%
Meshkuj	14.19%	11.25%	8.56%	7.22%	5.46%	5.01%
Në nivel kombëtar	17.23%	16.69%	16.40%	16.94%	15.63%	17.12%



Grafiku 1.7: Arritjet vjetore sipas gjinisë.

Tabela 1.11 paraqet informacion mbi nivelin e paqëndrueshmërisë së rezultateve vjetore, të krahasuara me rezultatet e fituara në provimin e arsimit bazë për lëndën e Gjuhës shqipe.

Tabela 1.11 lexohet si më poshtë:

- nga rreshti i parafundit i tabelës, lexojmë se, nga totali i nxënësve të vlerësuar gjatë vitit shkollor, vetëm **17.12%** e tyre kanë marrë notën 10 në lëndën e Gjuhës shqipe, ndërkohë që, nxënësit që edhe në provimin e gjuhës e kanë ruajtur vlerësimin me notën 10, përbëjnë **10.61%** të totalit të nxënësve;
- nëse rezultatet e nxënësve do të ishin të qëndrueshme, atëherë në PKAB duhet të rezultonin **17.12%** nota 10 në nivel kombëtar. Ndërkohë, ka ndodhur që nxënës të vlerësuar me notën 10 në procesin mësimor vjetor, në provimin kombëtar janë vlerësuar me notën 5 (**0.00%**) notën 6 (**0.15%**), notën 7 (**0.15%**), notën 8 (1.11%), notën 9 (**5.24%**) dhe notën 10 (**10.61%**);
- këto shifra tregojnë se nxënësit e vlerësuar me notën 10 gjatë vitit shkollor, në provimin kombëtar janë vlerësuar edhe me notën 6, 7, 8 apo 9. Pra, vlerësimi i tyre është ulur me 2-3 nota, por ka raste kur ulja e vlerësimit është edhe me 4 nota.

Të dhënat e Tabelës 1.11 tregojnë se një përqindje e caktuar e nxënësve, të cilët janë vlerësuar gjatë vitit shkollor me notën 5 e 6, në provimin kombëtar kanë arritur të marrin vlerësimin 7, 8 e 9.

Nga **16.69%** e nxënësve që gjatë vitit shkollor janë vlerësuar me notën 6, vetëm 2.12% e tyre kanë mbajtur po atë notë në provimin kombëtar.

Dukuria e *paqëndrueshmërisë së njohurive* lidhet me shkallën e fiktivitetit në shkollë, ndërsa dukuria e vlerësimit me 2-3 nota më lart në provimin kombëtar tregon për *nivel të ulët të monitorimit të mjediseve të provimit*.

Tabela 1.11: Vlerësimi i qëndrueshmërisë së notës.

Notat vjetore në %		Notat e PKAB në përqindje						
		Nota 4	Nota 5	Nota 6	Nota 7	Nota 8	Nota 9	Nota 10
5	17.23%	0.12%	2.32%	5.12%	5.98%	3.05%	0.54%	0.08%
6	16.69%	0.00%	0.63%	2.12%	5.95%	5.84%	2.02%	0.13%
7	16.40%	0.00%	0.12%	0.70%	3.38%	7.06%	4.34%	0.79%
8	16.94%	0.00%	0.04%	0.26%	1.66%	5.56%	7.30%	7.30%
9	15.63%	0.00%	0.01%	0.06%	0.59%	2.92%	7.45%	4.61%
10	17.12%	0.00%	0.00%	0.15%	0.15%	1.11%	5.24%	10.61%
Gjithsej	100.00%	0.14%	3.11%	8.42%	17.72%	25.53%	26.89%	23.52%

1.9 Të dhëna të tjera për rezultatet e provimit të Gjuhës shqipe

Grafiku 1.8, paraqet shpërndarjen e pikëve të fituara nga nxënësit në provimin e arsimit bazë, në lëndën “Gjuhë shqipe” 2022. Grafiku tregon se kemi një shpërndarje normale të arritjeve të nxënësve në provimin e arsimit bazë. Maksimumi është arritur në 38 pikë nga 1235 nxënës.



Grafiku 1.8: Shpërndarja e pikëve për provimin e arsimit bazë, Gjuhë shqipe.

Në përfundim mund të themi:

Rezultatet e arritjeve të nxënësve në testin e **Gjuhës shqipe, PKAB 2022**, (duke u nisur nga të dhënat e mësipërme) klasifikohen si më poshtë

- **Dobët** (vlerësuar me notën **4** në PKAB 2021). Sipas statistikave rezulton se **0.12 %** e nxënësve nuk e kanë kapërcyer nivelin minimal të arritjeve.
- **Mjaftueshëm** (përfshihen nxënësit që kanë nivelin e parë dhe që kanë fituar notën **5** dhe **6**). Nga tabela rezulton se **2.32%** e nxënësve kanë marrë notën 5 dhe **2.12%** e nxënësve kanë marrë notën 6. Nga një analizë e këtyre të dhënave, vërejmë se ky grup nxënësish kanë siguruar arritjet e mëposhtme:
 - përdorin drejt njohuritë për të kuptuar në mënyrë **të përgjithshme** tekstin.
 - dallojnë faktin nga opinioni.
 - gjejnë kuptime të fjalëve të thjeshta.
 - identifikojnë detajet më të dukshme.
 - zbulojnë temën kryesore të fragmenteve.
 - dallojnë numrit njëjës dhe shumës.
 - përmbahen brenda temës së esesë.
 - shtellojnë **shumë pak** idenë e një paragrafi.
 - zbulojnë raporte të thjeshta shkak-pasojë.
 - shkruajnë saktë fjalë të thjeshta.
 - dallojnë lidhëzat dhe klasat më kryesore të fjalëve (emër, mbiemër).

- perifrazojnë në mënyrë **sipërfaqësore** informacionet kryesore të tekstit.
- **Mirë** (përfshihen nxënësit që kanë fituar nivelin e dytë të arritjeve, nivel që përkon me notat **7-8**), ku **3.38 %** e nxënësve kanë fituar notën 7 dhe **5.56 %** kanë fituar notën 8. Nxënësit e këtij grupimi, në përputhje me kompetencat e arritjeve, zotërojnë aftësitë e mëposhtme:
- bëjnë shpjegime të pjesshme, duke u bazuar në tekstet.
 - dallojnë idenë kryesore të tekstit.
 - argumentojnë në mënyrë të përgjithshme mendimet e tyre.
 - analizojnë fjali të thjeshta që realizojnë përshkrime të personazheve.
 - dallojnë marrësin e mesazhit në skemën e komunikimit.
 - zbulojnë gjendjen shpirtërore të personazhit.
 - dallojnë përemrat, parafjalët dhe trajtat e shkurtra.
 - zbulojnë shkallët e mbiemrave.
 - shpjegojnë llojet e kallëzuesve të thjeshtë e të përbërë.
 - shpjegojnë funksionet e fjalëve në fjali.
 - organizojnë fakte dhe ide në përshtatje me qëllimin dhe llojin e tekstit.
 - përdorin **relativisht** drejt shenjat e pikësimit.
- **Shumë mirë** (përfshin nivelin e tretë të arritjeve, që përkon me notat **9 dhe 10**). Nga tabela rezultojnë se **7.45 %** e nxënësve kanë marrë notën **9** dhe **10.61 %** kanë marrë notën **10**, të cilët, në përputhje me kompetencat e arritjeve, zotërojnë, veç të tjerash, edhe aftësitë e mëposhtme:
- vlerësojnë në thellësi informacionet në tekst.
 - bëjnë lidhje mes tekstit dhe ideve të tjera jashtë tekstit në një situatë të re.
 - ndërtojnë lloje të ndryshme fjalish.
 - nxjerrin përfundime mbi çështje të rëndësishme në tekst.
 - përfytyrojnë situata që rrjedhin nga logjika e tekstit.
 - përdorin strategji personale për të bindur lexuesin.
 - formojnë fjali të llojeve të ndryshme.
 - përshtatin në kohë e mënyrë gjymtyrët kryesore dhe të dyta të fjalisë.
 - përdorin drejt në të gjitha rastet shenjat e pikësimit.
 - interpretojnë informacionet e marra nga teksti me burime të tjera të informacionit.
 - kanë stil origjinal në punën me shkrim.
 - formojnë fjali të llojeve të ndryshme, duke përdorur drejt rregullat e koherencës dhe kohezionit.
 - analizojnë në thellësi personazhet e fragmenteve.

II. Lënda: Matematikë

2.1 Arritjet e Nxënësve

Tabela 2.1 paraqet pikët mesatare të fituara nga nxënësit e çdo ZVA, në provimin kombëtar të Matematikës.

Tabela 2.1: Arritjet mesatare për çdo ZVA

Nr	ZVA	Pikë mesatare	Shmangia mesatare	Nota mesatare e provimit	Shmangia mesatare	Nota mesatare vjetore	Shmangia mesatare
Në nivel kombëtar		29.29	10.64	7.44	1.48	7.03	1.74
1	Belsh	29.90	9.56	7.47	1.34	6.93	1.63
2	Berat	28.68	9.90	7.37	1.35	7.36	1.79
3	Bulqizë	21.92	9.29	6.46	1.32	6.30	1.56
4	Cërrik	25.82	10.91	6.96	1.55	6.67	1.64
5	Devoll	29.22	9.86	7.43	1.34	7.20	1.78
6	Dibër	26.31	8.72	7.06	1.20	6.74	1.71
7	Divjakë	24.86	9.27	6.85	1.32	6.60	1.73
8	Durrës	31.48	10.76	7.76	1.49	6.91	1.75
9	Elbasan	29.05	11.22	7.32	1.54	7.02	1.75
10	Fier	26.85	10.19	7.13	1.42	6.99	1.65
11	Finiq-Dropull	30.46	8.89	7.65	1.22	7.35	1.57
12	Gjirokastër-Libohovë	27.47	10.81	7.25	1.51	7.04	1.76
13	Gramsh	33.56	9.54	8.05	1.32	7.80	1.49
14	Has	35.08	9.15	8.20	1.27	7.16	1.78
15	Kamzë	22.87	7.98	6.59	1.17	6.56	1.56
16	Kavajë	32.94	11.14	7.94	1.55	7.18	1.87
17	Klos	24.54	8.85	6.85	1.24	6.97	1.62
18	Kolonje	28.71	9.54	7.42	1.32	7.28	1.81
19	Korçë-Pustec	29.85	11.41	7.52	1.55	7.16	1.89
20	Krujë	28.43	9.51	7.34	1.32	7.06	1.66
21	Kuçovë	22.68	9.52	6.52	1.41	6.65	1.56
22	Kukës	30.64	10.15	7.63	1.42	7.25	1.65
23	Kurbin	28.71	9.82	7.38	1.36	7.18	1.68
24	Lezhë	24.21	9.62	6.77	1.36	6.75	1.65
25	Librazhd	29.24	9.72	7.43	1.36	7.28	1.68
26	Lushnje	34.07	11.50	8.08	1.55	7.31	1.77
27	Malësi e Madhe	25.31	8.67	6.92	1.21	6.57	1.68
28	Maliq	27.04	10.79	7.12	1.50	6.74	1.76
29	Mallakastër	30.04	9.73	7.55	1.37	7.21	1.71

30	Mat	27.48	12.52	7.15	1.70	6.97	1.73
31	Mirditë	24.63	9.55	6.82	1.38	7.01	1.66
32	Patos	25.02	7.78	6.91	1.11	6.70	1.65
33	Peqin	30.24	12.06	7.57	1.63	7.17	1.75
34	Përmet-Këlcyrë	28.58	8.43	7.33	1.19	6.59	1.47
35	Përrenjas	26.64	8.68	7.11	1.24	6.92	1.66
36	Pogradec	32.61	11.23	7.84	1.53	7.69	1.80
37	Poliçan	27.40	7.72	7.23	1.06	6.83	1.66
38	Pukë	29.59	9.39	7.53	1.32	7.80	1.51
39	Roskovec	25.06	9.11	6.91	1.23	6.71	1.56
40	Rrogozhinë	32.06	10.43	7.84	1.44	6.84	1.62
41	Sarandë-Konispol -Delvinë	34.10	8.71	7.09	1.50	6.88	1.65
42	Selenicë	26.16	9.71	7.04	1.38	6.71	1.36
43	Shijak	30.55	10.05	7.68	1.36	6.87	1.73
44	Shkodër	30.50	10.45	7.61	1.43	6.84	1.78
45	Skrapar	21.71	8.10	6.42	1.13	7.18	1.71
46	Tepelenë-Memaliaj	24.09	10.68	6.73	1.47	7.45	1.69
47	Tiranë	31.81	10.45	7.82	1.45	7.26	1.78
48	Tropojë	35.26	9.79	8.29	1.36	7.50	1.78
49	Ura Vajgurore	24.02	9.21	6.73	1.32	6.64	1.66
50	Vau Dejës	25.06	10.08	6.87	1.43	6.46	1.61
51	Vlorë-Himarë	30.93	10.74	7.70	1.48	7.22	1.74
52	Vorë	24.18	8.05	6.75	1.16	6.73	1.60

Nisur nga tabela 2.1, duket qartë se:

- ZVA Tropojë kryeson me pikët mesatare më të larta **(35.26)** dhe një diferencë të PKAB-së me notën vjetore, me **0.79**.
- Ndërsa ZVA **Skrapar**, ka rezultatet më të ulta në pikë, vetëm **(21.71)** dhe një diferencë të notës vjetore me PKAB, me **0.76**.
- Nota mesatare më e lartë është 7.8, e arritur në ZVA Pukë dhe Gramsh, të cilat janë me pikët mesatare përkatësisht 29.59 dhe 33.56.
- Për t'u theksuar është që rritja nga viti i kaluar shkollor në treguesit mesatarë ka ecur si në treguesit vjetorë ashtu dhe në treguesit e PKAB-së për çdo ZVA .

2.2 Arritjet në nivel kombëtar

Në provimin e arsimit bazë, lënda Matematikë, morën pjesë **28986** nxënës.

Në **tabelën 2.2**, paraqiten arritjet mesatare të nxënësve në lëndën e Matematikës në **nivel kombëtar**, sipas **urbanizimit fshat/qytet** (referuar vendndodhjes së shkollës), sipas **gjinisë femra/meshkuj**, dhe sipas **sistemit publik/jopublik** të edukimit.

Tabela 2.2: Arritjet mesatare të nxënësve sipas kategorive.

Urbanizimi	Gjinia	Pikët e fituara në test		Nota e PKAB		Nota Vjetore	
		Mesatarja e pikëve	Shmangia mesatare	Nota mesatare	Shmangia mesatare	Nota mesatare	Shmangia mesatare
Në nivel kombëtar	Femra	31.66	10.51	7.77	1.45	7.53	1.68
	Meshkuj	27.08	10.28	7.13	1.44	6.57	1.66
	Total	29.29	10.64	7.44	1.48	7.03	1.74
Qytet	Femra	34.24	10.25	8.11	1.42	7.70	1.72
	Meshkuj	29.85	10.59	7.51	1.47	6.81	1.76
	Total	31.96	10.66	7.80	1.48	7.24	1.80
Fshat	Femra	28.13	9.80	7.30	1.35	7.29	1.60
	Meshkuj	23.14	8.39	6.60	1.21	6.23	1.44
	Total	25.58	9.44	6.94	1.32	6.75	1.61
Publik	Femra	31.04	10.42	7.68	1.43	7.45	1.68
(në nivel kombëtar)	Meshkuj	26.30	9.95	7.03	1.40	6.45	1.61
	Total	28.58	10.45	7.34	1.45	6.94	1.71
Qytet	Femra	31.07	10.59	7.67	1.47	7.09	1.78
	Meshkuj	33.51	10.29	8.01	1.43	7.59	1.73
	Total	28.86	10.37	7.37	1.45	6.64	1.71
Fshat	Femra	28.13	9.80	7.30	1.35	7.29	1.60
	Meshkuj	23.13	8.37	6.60	1.20	6.23	1.44
	Total	25.58	9.44	6.94	1.32	6.75	1.61
Jopublik	Femra	38.52	8.91	8.72	1.22	8.39	1.53
(në nivel kombëtar)	Meshkuj	36.15	9.78	8.39	1.32	7.91	1.66
	Total	37.32	9.43	8.55	1.28	8.15	1.61
Qytet	Femra	38.63	8.81	8.74	1.20	8.39	1.52
	Meshkuj	36.38	9.62	8.42	1.30	7.93	1.66
	Total	37.50	9.29	8.58	1.26	8.16	1.61
Fshat	Femra	26.55	11.66	7.18	1.78	8.18	2.04
	Meshkuj	25.52	11.32	6.96	1.62	7.20	1.50
	Total	25.83	11.26	7.03	1.65	7.50	1.72

Në nivel kombëtar:

- **mesatarja e pikëve** të fituara në provimin e arsimit bazë në lëndën e Matematikës është **29.29 pikë**, me shmangie mesatare **10.64**;
- **nota mesatare e provimit të arsimit bazë** është **7.44**, me shmangie mesatare **1.48**;
- **nota mesatare vjetore** është **7.03**, me shmangie mesatare **1.74**.

Në nivel kombëtar, nga krahasimi i vlerave të notës mesatare në provimin e arsimit bazë me notën mesatare vjetore, rezulton se ndryshueshmëria është me **0.41** njësi note. Rezultatet e nxënësve në provimin e arsimit bazë janë më të larta, krahasuar me arritjet vjetore të nxënësve.

2.3 Arritjet sipas urbanizimit qytet/fshat

Nëse analizojmë arritjet e nxënësve në nivel kombëtar, sipas elementëve të urbanizimit qytet/fshat të paraqitura në tabelën 2.2, rezulton se **mesatarja e pikëve të nxënësve të qytetit është më e lartë, ndaj nxënësve të fshatit** dhe, konkretisht, për çdo kategori kemi:

- në nivel kombëtar, arritjet e nxënësve sipas kategorive të urbanizimit fshat/qytet, tregojnë se kemi diferenca të dukshme mes arritjeve të nxënësve që kanë ndjekur shkollën në qytet, kundrejt atyre që e kanë ndjekur shkollën në fshat. Mesatarja e pikëve të nxënësve të qytetit rezulton të jetë **6.38 pikë** më e lartë, ndaj nxënësve të fshatit.
- për sistemin publik, mesatarja e pikëve të nxënësve të qytetit është **3.28 pikë** më e lartë, ndaj nxënësve të fshatit.
- për sistemin jopublik, mesatarja e pikëve të nxënësve të qytetit është **11.98 pikë** më e lartë ndaj nxënësve të fshatit.

2.4 Arritjet sipas gjinisë

Të dhënat e tabelës 2.2 tregojnë se:

- në provimin e arsimit bazë, arritjet mesatare të vajzave janë më të larta, krahasuar me arritjet mesatare të djemve.
- arritjet mesatare të vajzave janë **2.37 pikë** mbi mesataren e pikëve në nivel kombëtar.
- mesatarja e pikëve të fituara nga vajzat, në nivel kombëtar, është **31.66** pikë, ose **4.58** pikë më e lartë, se mesatarja e pikëve të fituara nga djemtë.
- arritjet e vajzave në provimin e arsimit bazë janë **0.24 njësi note** më të lartë, kundrejt arritjeve vjetore (në nivel kombëtar: **7.44** nota mesatare e PKAB-së; **7.53** nota mesatare vjetore dhe **7.77** nota e PKAB-së).
- për djemtë arritjet në provimin e PKAB janë **0.56 njësi note** më të larta kundrejt rezultateve vjetore të tyre (në nivel kombëtar: **7.44** nota mesatare PKAB; **6.57** nota mesatare vjetore dhe **7.13** nota e PKAB-së).

2.5 Arritjet sipas sistemit publik/jopublik të edukimit

Nga analiza e të dhënave rezulton se:

- arritjet mesatare të nxënësve në sistemin jopublik të edukimit janë më të larta se arritjet e nxënësve të sistemit publik, kjo si për mesataren e pikëve të fituara në provim, po ashtu edhe për notën mesatare PKAB dhe atë vjetore.
- diferenca e pikëve mesatare mes sistemit jopublik dhe atij publik në nivel kombëtar është **8.74** pikë.
- në sistemin jopublik, ashtu si dhe në atë publik, arritjet e nxënësve në provimin e arsimit bazë janë më të larta, krahasuar me arritjet vjetore të tyre. Për sistemin jopublik kjo diferencë është **0.4** njësi note, ndërsa për atë publik, diferenca midis arritjeve vjetore dhe arritjeve në provimin e arsimit bazë janë **0.4** njësi note.

2.6 Qëndrueshmëria e arritjeve

Nëse do të analizojmë qëndrueshmërinë e arritjeve të nxënësve në provimin e arsimit bazë, kundrejt arritjeve vjetore, për lëndën e Matematikës, shihet se:


- për sistemin publik, arritjet e nxënësve të fshatit janë më të qëndrueshme, krahasuar me arritjet e nxënësve të qytetit, ndërsa për sistemin jopublik ndodh e kundërta.

Tabelat 2.3 dhe 2.4 paraqesin shpërndarjen (në përqindje) të notave të PKAB dhe notave vjetore për lëndën e Matematikës.

Tabela 2.3: Shpërndarja e notave për lëndën e Matematikës.

Sistemi i edukimit	Nota e PKAB në Matematikë						
	Nota 4	Nota 5	Nota 6	Nota 7	Nota 8	Nota 9	Nota 10
Publik	0.08%	8.58%	20.42%	24.06%	17.57%	11.75%	9.39%
Jopublik	0.00%	0.11%	1.17%	1.17%	1.84%	2.14%	2.41%
Në nivel kombëtar	0.08%	8.69%	21.59%	25.23%	19.41%	13.89%	11.80%

Shpërndarja e Notave Të PKAB për Matematikën



Grafiku 2.1: Shpërndarja e notave PKAB-së, për lëndën e Matematikës.


Në provimin e arsimit bazë, në nivel kombëtar:

- kalueshmëria është **99.9%**;
- nota mbizotëruese është **nota 7 me 25.23%**;
- përqendrimi më i madh është në notat 6, 7,8 dhe 9, të cilat së bashku përbëjnë **80.12%**;
- përqindja e nxënësve të vlerësuar me notën 10 shkon në **11.80%**;

Tabela 2.4: Shpërndarja e notave vjetore për lëndën e Matematikës.

Sistemi i edukimit	Nota e vjetore në Matematikë					
	Nota 5	Nota 6	Nota 7	Nota 8	Nota 9	Nota 10
Publik	25.83%	18.80%	14.01%	12.54%	10.05%	10.63%
Jopublik	0.58%	0.96%	1.32%	1.44%	1.49%	2.35%
Në nivel kombëtar	26.42%	19.75%	15.33%	13.98%	11.54%	12.98%

Shpërndarja e Notave Vjetore të Matematikës




Grafiku 2.2: Shpërndarja e notave vjetore për lëndën e Matematikës.

Për notat vjetore, në nivel kombëtar:

- nota mbizotëruese është nota **5 me 26.42%**;
- përqendrimi më i madh është në notat 5,6 dhe 7, të cilat së bashku përbëjnë **61.5%**;
- përqindja e nxënësve të vlerësuar me notën 9 shkon në **11.54%**
- përqindja e nxënësve të vlerësuar me notën 10 shkon në **12.98%**

Grafiku 2.3 paraqet një krahasimin midis arritjeve në provimin e arsimit bazë dhe atyre vjetore.



Grafiku 2.3: Arritjet ne provimin e Matematikës

2.7 Arritjet sipas urbanizimit qytet/fshat

Tabela 2.5 paraqet arritjet në provimin e arsimit bazë, lënda Matematikë, sipas urbanizimit.

Tabela 2.5: Shpërndarja e notave të Matematikës sipas urbanizimit.

Urbanizimi	Nota e PKAB në Matematikë						
	Nota 4	Nota 5	Nota 6	Nota 7	Nota 8	Nota 9	Nota 10
Qytet	0.01%	3.33%	9.20%	13.09%	12.60%	10.23%	9.79%
Fshat	0.07%	5.36%	11.70%	12.14%	6.81%	3.66%	2.01%
Në nivel kombëtar	0.08%	8.69%	20.90%	25.23%	19.41%	13.89%	11.80%

Sipas të dhënave të tabelës 2.5:

- Përqindja e nxënësve që kanë marrë notën 10 në provimin e arsimit bazë, është **11.80%** e numrit të përgjithshëm të nxënësve, prej të cilëve vetëm **2.01%** janë nxënës që i përkasin kategorisë-fshat, ndërsa pjesa tjetër prej **9.79%** i përkasin kategorisë-qytet.
- Shihet se, për kategorinë- qytet, nota me përqindjen më të lartë është nota 7 me **13.09 %**, gjithashtu edhe për kategorinë- fshat është nota 7, me **12.14%** të nxënësve.

Tabela 2.6: Shpërndarja e notave vjetore të Matematikës, sipas urbanizimit.

Urbanizimi	Nota vjetore në Matematikë					
	Nota 5	Nota 6	Nota 7	Nota 8	Nota 9	Nota 10
Qytet	13.79%	10.58%	8.69%	8.17%	7.21%	9.82%
Fshat	12.62%	9.18%	6.64%	5.81%	4.33%	3.15%
Në nivel kombëtar	26.42%	19.75%	15.33%	13.98%	11.54%	12.98%

- për notat vjetore, sipas urbanizimit qytet/fshat vërejmë se **12.98%** e nxënësve ka marrë notën 10;
- gjithashtu vihet re se notën 10 e kanë marrë **9.82%** e nxënësve të qytetit dhe **3.15%** e nxënësve të fshatit.
- nota me përqindjen më të lartë është nota 5, të cilën e kanë marrë **26.42%** e nxënësve.

2.8 Arritjet sipas gjinisë femra/meshkuj

Tabela 2.7 paraqet arritjet në provimin e arsimit bazë, lënda Matematikë, sipas gjinisë.

Tabela 2.7: Shpërndarja e notave të Matematikës sipas gjinisë.

Gjinia	Nota e PKAB në Matematikë						
	Nota 4	Nota 5	Nota 6	Nota 7	Nota 8	Nota 9	Nota 10
Femra	0.04%	2.57%	7.39%	11.94%	10.55%	8.29%	7.53%
Meshkuj	0.04%	6.12%	13.51%	13.29%	8.86%	5.60%	4.27%
Në nivel kombëtar	0.08%	8.69%	20.90%	25.23%	19.41%	13.89%	11.80%


Tabela 2.8: Shpërndarja e notave vjetore të Matematikës sipas gjinisë.

Gjinia	Nota e vjetore në Matematikë					
	Nota 5	Nota 6	Nota 7	Nota 8	Nota 9	Nota 10
Femra	6.90%	8.97%	8.29%	8.29%	7.26%	8.54%
Meshkuj	19.52%	10.78%	6.99%	5.69%	4.28%	4.44%
Në nivel kombëtar	26.42%	19.75%	15.28%	13.98%	11.54%	12.98%


Për lëndën e Matematikës, rezulton:

- vajzat kanë rezultate më të larta se djemtë, si gjatë vitit shkollor, po ashtu edhe në provimin e arsimit bazë;
- përqindja e nxënësve që kanë marrë notën 10 në provimin e arsimit bazë, është **11.80%** e totalit të nxënësve, prej të cilëve **7.53%** janë vajza dhe vetëm **4.27%** janë djem;
- përqindja e mbetësve në provimin e arsimit bazë, për kategorinë “meshkuj” (**0.05%**), është më e madhe, krahasuar me kategorinë “femra” (**0.04%**);
- në rezultatet e provimit të arsimit bazë, për vajzat nota me përqindjen më të lartë është nota 7 (me **11.94%**), ndërsa për djemtë është nota 6 (me **13.51%**);
- në rezultatet vjetore, vihet re se për djemtë nota 5 ka përqindjen më të madhe, ndërsa për vajzat nota me përqindjen më të madhe është 6 (me **8.97%**).
- përqindja e nxënësve të vlerësuar me notën 10 gjatë procesit mësimor vjetor është **12.98%**, prej të cilëve **8.54%** janë vajza dhe **4.44%** djem. Po të krahasojmë me notën vjetore të PKAB-së, ajo është më e lartë. Në PKAB, nota 10 është me **11.80%**, pra më e ulët se **12.98%** që kanë marrë notën 10 në notat vjetore. Kjo ka ardhur si rezultat i fiktivitetit në vlerësim.

Më poshtë paraqiten grafikisht të dhënat e tabelave 2.4 dhe 2.5.




Grafiku 2.4: Arritjet në provimin e arsimit bazë, lënda Matematikë, sipas gjinisë.



Grafiku 2.5: Arritjet vjetore në Matematikë, sipas gjinisë.

2.9 Të dhëna të tjera për rezultatet e provimit të Matematikës

Grafiku 2.6 paraqet shpërndarjen e pikëve të fituara nga nxënësit në provimin e arsimit bazë, në lëndën e Matematikës. Grafiku paraqet një shpërndarje relativisht jonormale, të zhvendosur ndaj boshtit vertikal.



